

2. VEPRIMTARITË KRYESORE TË MBIKËQYRJES GJATË VITIT 2016


Vëmendja e Bankës së Shqipërisë në funksionin mbikëqyrës ka qenë përmbyshja e objektivave për monitorimin në vijueshmëri, nëpërmjet inspektimeve në vend dhe analizave nga jashtë, të nivelit të rrezikut të bankave dhe mbarëvajtjes së administrimit të tyre. Kujdes i veçantë i është dhënë monitorimit të rreziqeve ndaj të cilave institucionet financiare janë më shumë të ekspozuara, si edhe ndaj institucioneve financiare të cilat përbëjnë një rëndësi të veçantë për funksionimin e mirë të sistemit financiar në Shqipëri. Viti 2016 u karakterizua nga një luhajtje e treguesit të kredive me probleme. Rënia e këtij treguesi, e evidentuar në fund të vitit 2016, pati burim shlyerjen/ristrukturimin e kredive me probleme si dhe fshirjen e tyre. Krahasuar me një vit më parë, treguesit kryesorë të përfitueshmërisë së bankave kanë demonstruar një pozicion më pak të favorshëm si rrjedhojë e rezultatit neto nga interesat më të ulëta dhe shpenzimeve për provigjione në nivele më të larta. Niveli i kapitalizimit të sistemit bankar mbetet i qëndrueshëm si dhe vijon monitorimi në vazhdimësi i praktikave dhe politikave të ndjekura nga grupet bankare të huaja të cilat kanë filiale në Shqipëri. Përsa i përket rrezikut operacional, me gjithë rritjen e kapitalit të alokuar specifikisht për këtë rrezik, theksi është vënë në përmirësimin e mëtejshëm të procesit të identifikimit dhe raportimit të humbjeve operacionale në sistem.

Përmbyshja e funksionit mbikëqyrës është kryer paralelisht me zhvillimin e kapaciteteve të brendshme, rishikimin dhe përmirësimin e strukturës mbikëqyrëse, roleve dhe përgjegjësisive, si edhe bashkëpunimin dhe koordinimin me autoritete të tjera rregullatore, brenda dhe jashtë vendit. Përveç veprimtarisë së zakonshme për mbikëqyrjen e subjekteve të licencuara, burimet e departamentit janë përqendruar dhe në zbatim të objektivave të strategjisë afatmesme të Bankës së Shqipërisë.

Ndër veprimtaritë kryesore përgjatë vitit 2016 veçohen:

2.1 ADRESIMI I KREDIVE ME PROBLEME

Në zbatim të planit kombëtar të masave për adresimin e kredive me probleme, në vitin 2016 janë ndërmarrë disa ndryshime që konsistuan në qartësimin e konceptit të fshirjes së kredive nga bilanci, në rishikimin e trajtimit mbikëqyrës të pronave të patundshme të marra në pronësi si pasojë e proceseve gjyqësore për ekzekutimin e kolateraleve të kredive me probleme, në rishikimin e kuadrit rregullativ për lehtësimin e shitjes së kredive me probleme si dhe u bënë disa përmirësime të nevojshme në regjistrin e kredive.




Thellimi i zbatimit të planit kombëtar të masave për adresimin e kredive me probleme mori po ashtu një vëmendje të veçantë. Dy çështje të rëndësishme të këtij plani, të cilat janë edhe detyrë e Bankës së Shqipërisë për t'u zbatuar, koordinimi i punës së bankave për zgjidhjen e 35 kredimarrësve të mëdhenj si dhe ristrukturimi jashtëgjyqësor i borxhit janë diskutuar me përfaqësues të Bankës Botërore me qëllim marrjen e ekspertizës mbi këto çështje që janë trajtuar në juridiksione të tjera të ngjashme ndërkombëtare. Nga ky bashkëpunim pritet të finalizohen dy dokumente të rëndësishme që janë: udhëzimi për ristrukturimin e kredive, që është rishikimi tërësor i udhëzuesve aktualë duke sjellë parimet më të mira ndërkombëtare, si dhe krijimi i një kuadri për bashkëpunim midis bankave për adresimin e duhur të problematikave të kredimarrësve të përbashkët.

Gjatë vitit 2016 u ndërmor një rishikim i përforcuar horizontal i ecurisë së kredive me probleme dhe përpjekjeve të ndërmarra nga bankat për adresimin e fenomenit. Me bankat e sistemit është komunikuar në mënyrë paralele duke trajtuar çështjen e cilësisë së portofolit, si në drejtim të trajtimit të kredimarrësve me probleme, ashtu edhe të fshirjes së kredive të kategorizuara të humbura sipas detyrimit rregullativ të përcaktuar. Njëkohësisht është kërkuar hartimi dhe paraqitja e Planeve të Rimëkëmbjes e të Zgjidhjes për kredimarrësit e mëdhenj të çdo banke siç përcaktohet edhe në kuadrin rregullativ përkatës për administrimin e rreziqeve të mëdha. Në fund të vitit 2016, Departamenti i Mbikëqyrjes u kërkoi bankave edhe formalizimin e strategjive për reduktimin e kredive me probleme, mënyrën e zbatimit të tyre, parashikimin për ndikimin në buxhet të shoqëruar me kërkesa për monitorim periodik të tyre. Ndjekja e ecurisë së këtyre fenomeneve do të vijojë me një frekuencë të shtuar edhe gjatë vitit 2017.

2.2 RISHIKIMI I PRAKTIKAVE MBIKËQYRËSE PËR QEVERISJEN KORPORATIVE

Banka e Shqipërisë, në kuadrin e objektivave të saj për përafrimin e praktikave mbikëqyrëse me praktikën e aplikueshme në vendet e Bashkimit Evropian, si dhe për hartimin e kuadrit rregullativ dhe metodologjive të cilat reflektojnë zhvillimet më të fundit në këtë drejtim, ka bashkëpunuar me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për mundësimin e një projekti që do të rishikojë çështje të drejtimit dhe administrimit të rrezikut për bankat. Qëllimi është që të rishikohen strukturat e qeverisjes, Këshillit Drejtues dhe komiteteve të ngritura, përbërjes së tyre, përgjegjësi dhe rolit që duhet të luajnë për të promovuar një ambient kontrolli eficient dhe transparent; qeverisjes me fokus administrimin e rreziqeve, veçanërisht atë të kredisë; vlerësimin dhe rregullimin e politikave të remunerimit; vlerësimin dhe rregullimin e funksioneve të përputhshmërisë dhe të kontrollit të brendshëm. Për të analizuar mjaftueshmërinë dhe nevojat potenciale për rishikim dhe rivlerësim të elementeve më sipër, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim do të fokusohet në vlerësimin e masës së implementimit të tyre në kuadrin ligjor, rregullator, si edhe dokumenteve të brendshme që mbështesin këtë proces. Projekti ka filluar në vitin 2016 dhe pritet të shtrihet edhe gjatë vitit 2017.



2.3 RISHIKIMI I STRUKTURËS SË MBIKËQYRJES

Në përmbushje të objektivave të strategjisë afatmesme të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë, në vitin 2016 u rishikua struktura organizative e Departamentit të Mbikëqyrjes. Qëllimi i këtij ndryshimi ishte ridimensionimi i praktikave të punës në funksion të rritjes së efikasitetit të proceseve si dhe përshtatja me zhvillimet e tregut. Nëpërmjet kësaj strukture u synua harmonizimi i analizave nga jashtë me kontrollin në vend të bankave për subjekte individuale, iu dha një fokus më i plotë analizave të rrezikut në nivel horizontal të të gjitha subjekteve të licencuara, u sigurova një qasje e njëjtë strukturore për subjektet me veprimtari të ngjashme, si dhe u krijuan procese të reja pune. Këto ndryshime reflektuan edhe nevojën për rritjen e kapaciteteve në dispozicion, si dhe rishikimin e rrjedhës së proceseve të punës dhe të përgjegjësive individuale për secilin pozicion pune.

2.4 RINDËRTIMI I SISTEMIT TË PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM

Gjatë vitit 2016 u krye një rishikim tërësor i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm duke qenë se ai ekzistues nuk i përmbushte nevojat e mbikëqyrjes dhe nuk i përgjigjej sfidave të zhvillimit, si atyre të brendshme institucionale ashtu edhe ecurisë së tregut bankar. Ky sistem konsiston në analizën periodike të disa treguesve kyç të vlerësimit të ecurisë financiare të bankave dhe paralajmëron në një periudhë të hershme zhvillime që kërkojnë vëmendje të shtuar mbikëqyrëse. Kjo metodologji shërben si një mbështetje mjaft e mirë e analizave nga jashtë duke e orientuar vëmendjen drejt rreziqeve që e meritojnë. Për ndërtimin e sistemit të ri u përfitua asistencë edhe nga Banka e Italisë dhe funksionimi i plotë i tij do të realizohet në 2017-ën. Megjithatë është parashikuar edhe një validim i mëtejshëm i tij në bashkëpunim me Bankën e Italisë për t'ia përafëruar qasjes dhe praktikave të institucioneve evropiane.

2.5 RITJA E KAPACITETEVE MBIKËQYRËSE NË BASHKËPUNIM ME BANKËN E ITALISË

Në funksion të përmbushjes së objektivave të zhvillimit si dhe për të përmbushur disa rekomandime të misionit të vlerësimit FSAP, në vitin 2016 filloi një projekt bashkëpunimi me Bankën e Italisë për disa aspekte të rëndësishme të punës së mbikëqyrjes.

- Fillimi i punës për zbatimin e kërkesave mbikëqyrëse sipas Bazelit III, që konsiston në rishikimin e kuadrit rregullativ për rrezikun e likuiditetit. Ky projekt përmban nevojën për asistencë për një sërë elementesh të rëndësishme në zbatimin e kuadrit rregullativ evropian përkatës dhe parimeve të Bazelit, fushë në të cilën Banka e Italisë ka ekspertizën e duhur për të asistuar në ndërtimin e kapaciteteve të brendshme.




- Rishikimi i rregullores "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit" me qëllim harmonizimin e mëtejshëm me direktivën dhe rregulloren evropiane të rishikuar për veprimtarinë e institucioneve të kreditit duke synuar përafrimin në vazhdimësi me kërkesat e Bazel II dhe të Bazel III.
- Rritjen e kapaciteteve të brendshme të departamentit për të siguruar një vlerësim më të mirë të kriterëve të përdorura nga bankat për kredihënien, duke përcaktuar kriteret për vlerësimin e analizës financiare që bëjnë bankat për kredimarrësit e tyre, si dhe duke vlerësuar mundësinë e përcaktimit të limiteve të treguesve financiarë kryesorë për sektorë të ndryshëm të ekonomisë.
- Rishikimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm në funksion të përmirësimit të analizës nga jashtë për t'i dhënë një dimension më të plotë qasjes së bazuar në rrezik nëpërmjet identifikimit të rreziqeve në mënyrë efikase sipas një metodologjie të ngjashme me institucionet homologe evropiane.
- Rishikimi i kërkesave mbikëqyrëse për institucionet e parasë elektronike lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të kuadrit rregullativ licencues dhe mbikëqyrës të këtyre institucioneve, si dhe përfitimi i eksperiencës për përmirësimin e procesit të analizave nga jashtë dhe të mbikëqyrjes në vend, në veçanti për forcimin e kërkesave mbikëqyrëse për sigurimin e fondeve të klientëve, të parandalimit të pastrimit të parave e të transparencës, si dhe të modeleve të planeve të biznesit e realizueshmërisë së tyre nga subjektet si dhe të vlerësimit nga rregullatori.

2.6 PËRMIRËSIMI I KUADRIT LIGJOR DHE RREGULLATOR

Gjatë vitit 2016, ndërhyrja në kuadrin ligjor dhe rregullator vijoi të synojë plotësimin dhe përmirësimin në vazhdimësi të tij me direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian (BE) dhe praktikat më të mira. Departamenti i Mbikëqyrjes kontribuoi në hartimin dhe finalizimin e ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka" i cili u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në dhjetor 2016. Gjithashtu, në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe me palët e interesit u hartua ligji për funksionimin e shoqërive të kursim-kreditit, ligj i cili u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në maj 2016. Si rrjedhojë, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016 u rishikua i tërë kuadri rregullator për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit, që konsiston në rregulloren për procesin e licencimit, rregulloren për kriteret e administrimit të rrezikut në veprimtarinë e këtyre subjekteve, si dhe sistemin për raportimin e informacionit periodik mbi veprimtarinë e tyre financiare. Të tjera akte të përgatitura dhe të konsultuara brenda departamentit përgjatë vitit përfshijnë Udhëzuesin sipas kërkesave të Shtyllës 2 të Akordit të Kapitalit të Komitetit të Bazelit dhe të direktivës dhe rregullores evropiane për kërkesat mbi procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit (ICAAP – *Internal Capital Adequacy Assessment Process*) si dhe rregulloren "Për mbikëqyrjen e konsoliduar"¹.

¹ Të tjera detaje mbi ndryshimet dhe përmirësimet rregullative jepen në seksionin "Kuadri rregullativ".



HAPËSIRË INFORMUESE 1. LIGJI PËR RIMËKËMBJEN DHE NDËRHYRJEN E JASHTËZAKONSHME NË BANKA

Ligji ka si objektiv kryesor krijimin e një baze të qartë ligjore për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në rastet kur këto të fundit përballen me kriza financiare, dhe synon të përafrojë pjesërisht legjislacionin shqiptar me Direktivën 2014/59/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 15 maj 2014 (Banking Recovery and Resolution Directive).

Dispozitat e këtij ligji vendosin në dispozicion të Bankës së Shqipërisë, si Autoritet i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, një tërësi instrumentesh ligjore për të ndërhyrë në një fazë mjaftueshëm të hershme dhe të shpejtë në rastin e një banke në pozita jo të shëndosha, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e funksioneve financiare dhe ekonomike me rëndësi kritike të bankës, gjithmonë duke minimizuar efektin tek ekonomia dhe sistemi financiar.

Subjekte të ligjit do të jenë bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ligji parashikon katër instrumente kryesore për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka respektivisht: bankën urë, shitjen e aktivitetit tregtar, ndarjen e aktiveve dhe rikapitalizimin nga brenda. Ndërkohë që instrumenti i bankës urë është tashmë i njohur në legjislacionin bankar, instrumentet e tjera prezantohen për herë të parë në një legjislacion të posaçëm për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen në bankat me probleme.

Zbatimi i instrumenteve të parashikuara në ligj do të konsiderojë parimin e proporcionalitetit bazuar në natyrën e aktivitetit, strukturën aksionere, formën ligjore, profilin e rrezikut, madhësinë dhe statusin ligjor, ndërlidhjen me institucionet e tjera dhe me sistemin financiar në Shqipëri, qëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre, pjesëmarrjen e tyre në skema mbrojtëse ose ndonjë sistem tjetër të përbashkët.

Në funksion të zbatimit të instrumenteve të parashikuara nga ligji, përcaktohen dispozita të veçanta lidhur me krijimin, financimin, përdorimin dhe administrimin e fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Ky fond financohet kryesisht nga kontributet vjetore dhe kontributet e jashtëzakonshme të paguara nga bankat, si dhe administrohet nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Niveli i synuar i Fondit parashikohet të plotësohet brenda një periudhe tranzitore 10-vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

